



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010) dhe nenin 4, paragrafi 3 dhe nenin 65, paragrafi 3 të Ligjit 05/L-045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2016 miratoi:

Rregullore mbi Raportimin e Siguruesve në BQK

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë afatet, rregullat, format dhe mënyrën e raportimit të Siguruesve në BQK.
2. Kjo Rregullore aplikohet për të gjithë siguruesit e licencuar nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjithë termat e përdorur në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë, ashtu siç janë përcaktuar në nenin 3 të Ligjit nr.05/L-045 për Sigurimet (më tutje: Ligji për Sigurimet) dhe/ose siç definojnë këtu për qëllime të kësaj rregulloreje:
 - a) *Certifikata e raportimit* - nënkupton certifikatën unike të sigurisë e cila mundëson raportimin e siguruesve në sistemin elektronik, vërteton se të dhënat e siguruesit janë të enkriptuara dhe se në momentin që të dhënat importohen në sistemin rregullativ të raportimit “Off-Site” (angl. Off-Site Regulatory Reporting System - ORRS) siguruesi dhe personat përgjegjës marrin përgjegjësinë se të dhënat janë përfundimtare dhe të raportuara saktë.
 - b) *ORRS* - nënkupton sistemin softuerik për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të raportuara nga siguruesit.
 - c) *Udhëzimet për raportim* - nënkuptojnë udhëzimet e aprovuara nga BQK-ja për raportimin e siguruesve në BQK, ku janë të specifikuara format e raportimit, udhëzimet e detajuara për plotësimin e formave në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNRF) si dhe në pajtim me rregulloret e veçanta të BQK-së.
 - d) *E-mail robot* - nënkupton formatin elektronik të pranimit të raporteve nga siguruesit, që pranohet si formë e raportimit në ORRS në Excel.

Neni 3

Kërkesat e Përgjithshme

1. Çdo sigurues, duhet t'i dorëzojë BQK-së, raportet të cilat kanë të bëjnë me gjendjen e saj financiare, administrimin dhe operacionet e saj, qoftë në baza individuale apo të konsoliduara. Në bazë të kësaj rregulloreje, një sigurues i jashtëm do t'i konsolidojë të dhënat e të gjitha degëve në një raport të vetëm.
2. Raportet përgatiten vetëm në format dhe udhëzimet e përcaktuara nga BQK-ja, të cilat mund të ndryshohen dhe plotësohen kohë pas kohe nga BQK-ja.
3. Siguruesit dorëzojnë raportet financiare në Departamentin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në BQK, tridhjetë ditë (30) ditë pas përfundimit të tremujorit, përkatësisht sipas afateve të përcaktuara si më poshtë:
 - a) për tremujorin e parë (janar-mars) deri me 30 prill të vitit aktual,
 - b) për tremujorin e dytë (janar-qershor) deri me 31 korrik të vitit aktual,
 - c) për tremujorin e tretë (janar-shtator) deri me 31 tetor të vitit aktual,
 - d) për vitin e plotë kalendarik (janar-dhjetor) deri me 31 janar të vitit vijues,

Neni 4

Raportet e Siguruesve dhe Afatet e Raportimit

1. Siguruesit duhet t'i dorëzojnë Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve në BQK, jo më vonë se tridhjetë ditë (30) pas përfundimit të çdo tremujori, raportet si në vijim:
 - a) faqja e parë (FP)
 - b) ditari kryesor i llogarive (DKLL)
 - c) bilanci i gjendjes i gjeneruar nga DKLL (BGJ)
 - d) pasqyra e të ardhurave e gjeneruar nga DKLL (PA)
 - e) bilanci i gjendjes (F01)
 - f) pasqyra e të ardhurave (F02)
 - g) pasqyra e përgjithshme e të ardhurave (F03)
 - h) pasqyra e ndryshimeve në ekuitet (F04)
 - i) pasqyra e rrjedhës së parasë (F05)
 - j) raporti i Rezervave Teknike (F06)
 - k) raporti i Llogarive Teknike (F07)
 - l) raporti i shpenzimeve operative neto (F08)
 - m) raporti i Analizës Teknike (F09)
 - n) raporti i margjinës së Solvencës në dispozicion (F10)
 - o) margjina minimale e Solvencës (F11)
 - p) margjina e Solvencës (F12)
 - q) investimet vlerën dhe llojin (F13)
 - r) raporti i riskut sigurues (F15)
 - s) tabela e mortalitetit për sigurimet e jetës (F16)

2. Siguruesit në pajtim me paragrafin 3 të Nenit 3 të kësaj Rregulloreje duhet t'i dorëzojnë Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve në BQK, përveç raporteve të specifikuara si në paragrafin 1 të këtij neni edhe raportet si në vijim:
 - a) raportin dhe opinionin e aktuarit
 - b) strukturën e asetëve të investuara në mbulim të provizioneve teknike
 - c) normat e likuiditetit
 - d) rreziqet e marra për çdo klasë sigurimi;
 - e) informacionet për Ri siguruesit, programin dhe kontratat
 - f) format e raportimit për Ri siguruesit
 - g) analitikën e llogarive të arkëtueshme
 - h) analitikën e Llogarive të pagueshme
 - i) analitikën e primeve të shkruara
 - j) analitikën e dëmeve
 - k) listën e të punësuarve
3. Siguruesit duhet t'i dorëzojnë Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve në BQK jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike pas përfundimit të çdo muaji raportet mujore si në vijim:
 - a) raportin mujor të primeve të shkruara bruto
 - b) raportin mujor të dëmeve të paguara dhe dëmeve pezull
 - c) raporte të tjera me kërkesë të BQK-së
4. Siguruesit duhet t'i dorëzojnë Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve në BQK jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike pas përfundimit të çdo gjashtëmujori, përveç raporteve të specifikuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni edhe raportet si në vijim:
 - a) pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave (F03)
 - b) pasqyra e ndryshimeve në ekuitet (F04)
 - c) pasqyra e rrjedhës së parasë (F05).
5. Përpos formave dhe raporteve të përcaktuara në paragrafët e mësipërm të këtij neni, Siguruesit duhet ti dorëzojnë Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve në BQK, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike pas përfundimit të çdo tremujori, edhe format suplementare për aftësi paguese (Solvencë), asetet në mbulim të provizioneve teknike, raportin e risigurimit, listën mbi vjetërsinë e debitorëve dhe të arkëtueshmeve të tjera, si dhe informata të tjera sipas kërkesës së BQK-së.

Neni 5

Raportimi i konsoliduar

1. Siguruesit të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar sipas nenit 90 dhe 91 të Ligjit për Sigurimet dhe të Rregullores për mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve të sigurueseve, duhet t'i dorëzojnë Departamentit të Mbikëqyrjes së sigurimeve në BQK, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike pas përfundimit të vitit, raportet si në vijim:
 - a) faqja e parë (FP)

- b) ditari kryesor i llogarive (DKLL)
 - c) bilanci i gjendjes i gjeneruar nga DKLL (BGJ)
 - d) pasqyra e të ardhurave e gjeneruar nga DKLL (PA)
 - e) raporti i margjinës së Solvencës në dispozicion (F10)
 - f) margjina minimale e Solvencës (F11)
 - g) margjina e Solvencës (F12)
 - h) investimet (F13)
2. Siguruesit të cilët janë subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar sipas “Rregullores për mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve të siguruesve” duhet t’i dorëzojnë Departamentit të Mbikëqyrjes së sigurimeve në BQK, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike pas përfundimit të çdo gjashtëmujori, përveç raporteve të specifikuara në pikën 1 të këtij neni edhe raportet si në vijim:
- a) pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave (F03)
 - b) pasqyra e ndryshimeve në ekuitet (F04)
 - c) pasqyra e rrjedhës së parasë (F05)
3. Siguruesit në një grup sigurimi duhet t’i raportojnë Departamentit të Mbikëqyrjes së sigurimeve në BQK të gjitha transaksionet e rëndësishme brenda grupit, respektivisht transaksioneve që kanë të bëjnë me persona dhe palë të ndërlidhura.

Neni 6

Raportimi i Degëve të siguruesve të jashtëm për siguruesit Mëmë

1. Degët e sigurueseve të jashtëm përveç raporteve të kërkuara sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje lidhur me aktivitetin e tyre në Kosovë, gjithashtu duhet t’i dorëzojnë Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve në BQK, deri më datë 31 Maj të çdo viti edhe raportet financiare të siguruesit mëmë, si në vijim:
- a) raportin e mjaftueshmerisë së kapitalit;
 - b) kapitalin rregullator (fondet e veta);
 - c) raportin mbi adekuatshmërinë e Aftësisë Pagueuse (Solvences);
 - d) raportin mbi adekuatshmërinë e provizioneve teknike;
 - e) raportin e dëmeve;
 - f) raportin e shpenzimeve;
 - g) raportin e kombinuar;
 - h) treguesin e kthimit në Asete mesatare (ROAA);
 - i) treguesin e kthimit në Ekuitet mesatar (ROAE);
 - j) treguesin e mjeteve likuide ndaj provizioneve teknike dhe ndaj gjithsej detyrimeve;

Neni 7

Raporti Vjetor

1. Siguruesit, deri më 30 Prill të çdo viti duhet t’i dorëzojnë BQK-së raportin vjetor së bashku me raportin dhe opinionin e aktuarit lidhur me adekuatshmërinë e provizioneve teknike,

raportin dhe mendimin e auditorit të jashtëm si dhe letrën e menaxhmentit për vitin e kaluar financiar.

2. Siguruesit pas raportit të auditorit të jashtëm duhet të ri dorëzojnë raportet e përcaktuara në nenin 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje në pajtim me afatet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Degët e siguruesve të jashtëm, përveç obligimit në paragrafin 1 të këtij neni, duhet t'i dorëzojnë BQK-së raportin vjetor të konsoliduar të siguruesit mëmë së bashku me mendimin e aktuarit dhe auditorit të jashtëm, brenda 4 javësh nga lëshimi i tyre.
4. BQK në rastet kur e vlerëson si të nevojshme, mund të kërkojë nga degët e siguruesve të jashtëm të dorëzojnë në BQK raportin vjetor të konsoliduar të siguruesit mëmë.

Neni 8

Raportimi Shtesë

1. Siguruesit duhet që në baza të rregullta tremujore dhe vjetore të llogarisin dhe të hartojnë raportet lidhur me: (i) kapitalin; (ii) fondin garantues; (iii) nivelin e kërkuar të aftësisë paguese; sipas Rregullores për *“Kalkulimin e kapitalit, fondit garantues dhe adekuatshmërisë së kapitalit për siguruesit”*.
2. Siguruesit duhet të raportojnë në Departamentin e Statistikës në BQK jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendrike pas përfundimit të çdo muaji të dhënat lidhur me pasqyrën e bilancit të gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave, të nevojshme për ti mundësuar BQK-së që në baza mujore të përpilojë pasqyrat e agreguara të Siguruesve në nivel vendi:
 - a) statistika - bilanci i gjendjes (Jo-Jetë) (F17)
 - b) statistika - pasqyra e të ardhurave (Jojetë) (F18)
 - c) statistika - pasqyra e të ardhurave (Jetë) (F19)
3. BQK mund të kërkojë nga siguruesit, sipas nevojës dhe rastit, që të raportojnë më shpesh, më gjerësisht ose të kërkojë raporte të tjera kur konsiderohen të nevojshme, me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisive mbikëqyrëse.

Neni 9

Detyrimet dhe mënyra e raportimit të siguruesve

1. Siguruesit duhet të dorëzojnë raportet në afatet dhe në formën e përcaktuar nga BQK-ja, në përputhje me udhëzimet e aprovuara nga BQK-ja për raportim në sistemin ORRS.
2. Raportimi nga siguruesit sipas kësaj rregulloreje duhet të bëhet në formë elektronike (emali robot) në sistemin e raportimit ORRS në formatin xls.
3. Shkresa përcjellëse në formë fizike (sipas aneksit 1) për raportet e dërguara në formë elektronike sipas paragrafit 2 të këtij neni duhet të dorëzohet në BQK e vulosur dhe e nënshkruar nga kryeshefi ekzekutiv ose në mungesë të tij/saj i deleguari i tij/saj, zyrtari kryesor i financave dhe nga personi përgjegjës për raportim në sistem.

Neni 10

Plani i Biznesit

1. Siguruesit, jo me vonë se 30 nëntori i çdo viti duhet të dorëzojë në BQK planin e biznesit i cili duhet të përmbajë:
 - a) projeksionin e pasqyrës së bilancit të gjendjes (F01)
 - b) projeksionin e pasqyrës së të ardhurave (F02)
 - c) projeksionin e pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet (F04)
 - d) projeksionin e pasqyrës së rrjedhës së parasë (F05)
 - e) projeksionet për aftësi paguese-Solvenca (F10, F11, F12)
 - f) projeksionin për kalkulimin e riskut sigurues (F15).
2. Siguruesit, në baza të rregullta vjetore duhet të dorëzojnë në BQK politikën e shkruar të investimeve, e cila në detaje duhet të përshkruaj llojin dhe vlerën e investimeve, të cilat siguruesi planifikon t'i bëjë gjatë një viti.
3. Në zbatim të Rregullores për *“kërkesat e mbajtjes së rrezikut dhe mbulimit përmes ri sigurimit”*, siguruesit duhet të dorëzojë në BQK programin e planifikuar të risigurimeve i cili duhet të përmbajë llogaritjen e rreziqeve të mbajtura për secilën klasë sigurimi;
4. Siguruesit duhet të dorëzojnë në Departamentin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në BQK edhe kontratat e risigurimit të nënshkuara me risiguruesit sipas kriterëve të përcaktuara nga BQK-ja.
5. Plani i Biznesit, politika e investimeve si dhe programi i planifikuar i risigurimeve paraprakisht duhet të aprovohen nga bordi i drejtorëve të siguruesit.

Neni 11

Përgjegjësia për saktësinë e raportimit

1. Siguruesit marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar saktësinë e të dhënave të raportuara në BQK si dhe do të mbahen përgjegjës për saktësinë e tyre, në përputhje me nenin 9 të kësaj rregulloreje.
2. Personat e drejtpërdrejtë përgjegjës për sigurimin e saktësisë së të dhënave të raportuara në pajtim me nenin 9 të kësaj rregullore janë: kryeshefi ekzekutiv, zyrtari kryesor i financave, zyrtari kryesor i marrjes në sigurim dhe zyrtari kryesor i dëmeve.
3. Nëse Siguruesi identifikon se ekziston ndonjë pasaktësi në të dhënat e raportuara pas dërgimit të tyre në BQK, duhet të njoftoj menjëherë Departamentin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve lidhur me këto pasaktësi.
4. Nëse BQK konstaton se të dhënat e raportuara janë të pasakta, do të urdhërojë siguruesin të bëjë korrigjimin e tyre si dhe do të kërkoj përsëritjen e raportimit pas korrigjimeve të bëra.

Neni 12
Dispozitat përfundimtare

Në zbatim të kësaj rregulloreje Bordi Ekzekutiv i BQK-së do të nxjerrë udhëzime dhe formularë që përcaktojnë mënyrën dhe formën e raportimit.

Neni 13
Zbatimi, Masat Përmirësuese dhe Dënimet Civile

Çdo shkelje e dispozitave tjera të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjit nr.05/L-045 për Sigurimet.

Neni 14
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen dispozitat ligjore të Rregullores mbi “Depozitimin e aseteve si garancë, mjaftueshmerisë së kapitalit, raportimin financiar, menaxhimin e riskut, investimeve dhe likuiditetin” që ndërlidhen me raportimin.

Neni 15
Shtojca

Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje është Aneksi 1.

Neni 16
Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 korrik 2016.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci

Aneksi 1
Shkresa përcjellëse në formë fizike



Departamenti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve
Shkresa përcjellëse

Emri i siguruesit:

Kodi i siguruesit:

Adresa:

Lloji i Siguruesit:

Periudha e raportimit:

Forma (frekuenca) e raportimit:

Data e raportimit:

I pa audituar:

Data dhe ora e ngarkimit të raportimit:

Emërimi i raportit:

Formularët e raportimit:

Kodi	Emri i formularit	√
SGL	Ditari kryesor i llogarive - DKLL	
BS	Bilanci i gjendjes i gjenruar nga DKLL	
IS	Pasqyra e të ardhurave e gjeneruar nga DKLL	
F01	Pasqyra e Bilancit të Gjendjes	
F02	Pasqyra e të ardhurave	
F03	Pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave	
F04	Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	
F05	Pasqyra e rrjedhës së parasë	
F06	Pasqyra e Provizioneve teknike	
F07	Pasqyra e llogarive teknike	
F08	Pasqyra e shpenzimeve operative	

F09	Pasqyra e Analizës Teknike	
F10	Margjina e Solvencës në dispozicion (Jo-jetë)	
F10	Kalkulimi i aftësisë paguese (solvenca) (Jetë)	
F11	Margjina e Solvencës në dispozicion (Jo-jetë)	
F11	Aftësia paguese në dispozicion (Jetë)	
F12	Kalkulimi i aftësisë paguese (Solvencës) në bazë primi dhe dëmi (Jo-Jetë)	
F12	Aftësia paguese e kërkuar (Jetë)	
F13	Përfaqësimi i rezervave teknike sipas llojit dhe shumës	
F14	Trekëndëshat e dëmeve	
F15	Raporti i kalkulimit të riskut sigurues	
F16	Tabelat e mortalitetit (Jetë)	
F17	Bilanci i Gjendjes - Statistika	
F18	Pasqyra e të ardhurave - Statistika	
F19	Pasqyra e të ardhurave – Statistika (Jetë)	
	Raportin dhe opinionin e aktuarit	
	Strukturën e asetëve të investuara në mbulim të provizioneve teknike	
	Analitiken e llogarive të arkëtueshme dhe pagueshme	

Deklarata e zyrtarit përgjegjës për raportim, Kryeshefi ekzekutiv, Zyrtari kryesor i financave dhe Personi përgjegjës për raportim:

Përmes kësaj shkrese deklarojmë se raportet e ngarkuara në ORRS janë përgatitur në përputhje me kërkesat e BQK-së dhe udhëzimet për raportim. Raportet saktë reflektojnë kushtet e siguruesit deri në datën e raportimit. Është e kuptueshme se çdo paraqitje jo e drejtë, me qëllim në këtë raport mund të rezultojë me sanksione konform legjislacionit në fuqi që do të zbatohen kundër Kryeshefi ekzekutiv, Zyrtarit kryesor të financave dhe Personit përgjegjës për raportim si dhe / ose siguruesit që raporton.

Kryeshefi ekzekutiv:

(nënshkrimi)

Personi përgjegjës për raportim

(nënshkrimi)

Zyrtari kryesor i financave:

(nënshkrimi)